

ipko foundation

Hajdar Dushi Street, no. 52

10000 Prishtinë, Kosova

T +386 (0)49 196 655

info@ipkofoundation.org • ipkofoundation.org

Memorandum Mirëkuptimi

Ndërmjet

IPKO Foundation (IF)

dhe

Komuna e Gjakovës

Neni 1

Komuna e Gjakovës dhe IPKO Foundation janë pajtuar për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme jashtë shkollore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të të rinjëve të Komunës së Gjakovës.

Neni 2

Ky Memorandum i Mirëkuptimit lidhet ndërmjet palëve nënshkruese Komunës së Gjakovës dhe IPKO Foundation.

Neni 3

IPKO Foundation është fondacion që vepron në Kosovë që nga viti 2000, qëllimi i të cilit është të mbështesë inovuesit e rinj dhe zhvillimin e brezit të ardhshëm të liderëve me vizion digjital për Kosovën. IPKO Foundation investon drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të të rinjve të Kosovës duke nxitur edukimin e tyre, promovimin e edukimit jo formal, dhe theksimin e rritjen e aktiviteteve që synojnë edukimin jo formal, zhvillimin e gjeneratave të reja lidere në teknologji dhe inovacion. Në mënyrë që këto objektiva të realizohen në mënyrë të mirëfilltë dhe të rregullt, IPKO Foundation ka nevojë për mbështetje institucionale në këtë rast mbështetje të drejtpërdrejtë nga Komuna e Gjakovës për çasje në shkolla fillore dhe të mesme.

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është arritja e objektivave të përbashkëta dhe njëherit fuqizimi i të rinjëve në edukimin praktik dhe jo formal në Komunën e Gjakovës.

Neni 4

Ky Memorandum formon kornizën për bashkëpunimin midis palëve për të identifikuar dhe arritur qëllimet dhe objektivat e përbashkëta dhe për të lehtësuar dhe zhvilluar një proces shkëmbimi të singertë dhe reciprokisht të dobishëm. Ky Memorandum nuk është detyrues dhe nuk imponon asnjë detyrim ligjor apo financiar në asnjëra palë.

Neni 5

Ky Memorandum i Mirekuptimit do të mbetet në fuqi për katër vite që nga dita e nënshkrimit, përveç nëse ndonjera palë vendose ta përfundojë më heret duke njoftuar palën tjetër me shkrim, ose nëse aktivitetet e përbashkëta të parashikuara nga ky Memorandum përfundohen para përfundimit të periudhës së cekur.

Neni 6

Ky Memorandum është përpiluar në 2 (dy) dokumente origjinale në gjuhën shqipe.

Marrëveshja mund të priset vetëm nëse njëra nga palët nënshkruese argumenton mosfunksionimin e marrëveshjes. Për ndryshimet e mundshme, palët do të pajtohen gjithmonë duke u bazuar në këtë Memorandum.


Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese
Gjakovë, 23.02. 2018

Abetare Gojani

Drejtoreshë e Programeve (IF)

IPKO Foundation



Ardian Gjini

Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës



Data 23.02.2017